

Partia Socialiste ka paralajmëruar sot publikimin e një tjetër afere korruptive me dhënien e koncesioneve për ndërtimin e HEC-eve, ku në qendër të denoncimit është sërish ish-ministri i Ekonomisë Genc Ruli.

Sipas deputetes së PS-së Ermonela Felaj bëhet fjalë për koncesionin e HEC-eve në pellgun ujq Bënçë - Progonat në rrethin e Tepelenës.



Kryetari i [Këshillit të Ministrave.org](#) , prof.dr.mjeshtër [Sali Berisha](#) i cili gjithmonë karakterizohet nga një qetësi olimpikë, pas kësaj deklarate të deputetes socialiste ka reaguar i indinjuar.

“Na mërzitët me keto afera duke i nxjerrë një e nga një. Nuk e kuptoj përse nuk i publikoni të gjitha njëherësh?” u shpreh i inatosur kryeministri Berisha.

Berisha shpjegoi se situata e përmbytjeve të Shkodrës na bëri të mendonim seriozisht për të parandaluar cdo fakteqësi natyrore në të ardhmen.

Një shprehje e vjetër thotë “Uji flë, hasmi s’flë”. Por Shkodra për dy vjet rradhazi dëshmoi se ujërat i ka kapur pagjumësia dhe herë pas here dalin nga shtretërit duke përmbytur dynjanë.

Prandaj unë personalisht e kam nxitur ministrin Ruli që të gjejë kompanitë më të mira që

dinë të këndojnë ninulla për ti vënë lumenjtë dhe shirat në gjumë.

Ruli e di se c'ka hequr derisa gjeti bash ata që të mbaronin punë. Dhe faktikisht ata e bënë punën, pasi në atë zonë përmytje nuk ka patur. Kjo do të thotë që "miqtë" e kanë hallall koncesionin edhe për 100 vitet e ardhme.

"Kjo është opozita më e keqe që më ka rastisur. Këta bllokmenët e kuq e kanë bërë ves që tentojnë të godasin pikërisht ministrat e mi më të mirë. Në fakt, qeveria ime i ka të gjithë ministrat njërin më të mirë se tjetrin. Po të isha njeri pa kulturë do kisha kapur ndonjë gjë me dorë, për të mos i marrë më sysh "cunat" e [Këshillit të Ministrave.org](http://Keshillit_të_Ministrave.org)."

deklaroi Berisha duke shtuar se do t

ë kishte d

ëshir

ë ti kishte t

ë gjith

ë ministrat nj

ërin m

ë

rul se tjetrin

.

Kryeministri Berisha e ka siguruar ministrin Ruli se pamvarësisht nga publikimi i

dokumentave, bashk

ëpunimi

mes tyre do t

ë vazhdoj

ë.